



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

6357/Prot
05.11.2025
REPUBLICA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA E BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 683/1 prot.

Shkodër, më 31.10.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 57, 58, 59, datë 27.10.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", u njoh me Vendimet Nr. 57, 58, 59, datë 27.10.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, akte me karakter njohës, me karakter jo normativ.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK****VENDIM**Nr. 57 datë 27.10. 2025

“Për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.21 datë 26.03.2025 dhe Vkb nr.33 datë 28.04.2023, Vkb nr.80 datë 30.10.2022 për ngritjen e komisionit të strehimit”.

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Strehimit Social, dhe propozim të Kryetarit Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Ndryshimin e VKB-së Nr.21 dt.26.03.2025 dhe VKB Nr.33 dt.28.04.2023 , VKB Nr.80 dt.30.10.2023.

2. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:

- Dajana Lleshi – Kryetar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
- Silvana Ismailaj - Zv/ Kryetar, Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
- Marian Marku – Anëtar, Sektori i Buxhetit dhe Financës
- Indrit Kurtbegu -Anëtar, Sektori i Investimeve.
- Marketa Lleshaj - Anëtar, Drejtorja e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
- Suela Domnori- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
- Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”)i ndryshuar.

Kryetar KëshilliErvis **Shimaj****Sekretar Këshilli**Ardian **Çelepija**Miratuar me 17 votaVota Pro 17Vota Kunder —Vota Abstenim —Zbardhur me Datë 29.10. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13 datë 16.10. 2025

“Për miratimin e ndryshimit të VKB-së Nr.21 dt.26.03.2025 dhe

VKB Nr .33 dt.28.04.2023 ,VKB Nr 80 dt.30.10.2022 për ngritjen e Komisionit të Strehimit”

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “

Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Strehimit Social, Kryetar i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të :

VENDOSI

1. Ndryshimin e VKB-së Nr.21 dt.26.03.2025 dhe VKB Nr.33 dt.28.04.2023 ,VKB Nr.80 dt.30.10.2023.
2. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:
 - Dajana Lleshi – Kryetar, Drejtoria e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Silvana Ismailaj - Zv/ Kryetar, Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
 - Marian Marku – Anëtar, Sektori i Buxhetit dhe Financës
 - Indrit Kurtbegu -Anëtar, Sektori i Investimeve.
 - Marketa Lleshaj - Anëtar, Drejtoria e Mrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social
 - Suela Domnori- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
 - Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETARI
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni

Konceptoi: E.Gjecaj

Pranoi: D.Lleshi

Miratoi: R.Luzaku

Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

**DREJTORIA E MBROJTJES , PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL**

Vau Dejës, me 16 / 10 / 2025

RELACION

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “ n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ;në zbatim të ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin social”i ndryshuar; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, u krye ndryshimi i pjestarëve të Komisionit të Strehimit për shkak të largimit të nje antari nga detyrat funksionale në institucionet përkatëse.

Qëllimi është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më eficiente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky Komision në përputhje me normat juridike, duhet që, sa herë në Bashkinë Vau Dejës ka në zbatim një program social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efijencës së tij si organ kolegjal përballë aplikuesve.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni i Strehimit trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha dosjet e aplikantëve në programet e strehimit social.

Konceptoi: **E. Gjeçaj**